



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 169/2 Prot

Tiranë, më 10.03.2022

V E N D I M

Nr.35, datë 10.03.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së aktit nr. 17409, datë 1.10.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, për transferimin e përkohshëm të nëpunëses *** dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

Vërej se:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 993 prot., datë 18.10.2021, nga nëpunësja doganore *****, është ngritur pretendimi se, transferimi i saj i përkohshëm për nevoja të institucionit, në pozicionin “Specialiste, Sektori i Ankimimeve”, Drejtoria Juridike, pranë DPD, është i paligjshëm, pasi emërimi i saj në pozicionin nga i cili është transferuar si “Specialiste, Sektori i Administratës dhe Shërbimit”, Dega Doganore Tiranë, është bërë në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë, e cila, në vendimin e themelit, ka lënë në fuqi

masën e sigurisë në lidhje me pezullimin e aktit nr. 31307, datë 20.12.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, si dhe në kushtet kur nuk është shprehur ende Gjykata e Apelit.

Nga hetimi administrativ i këtij rasti, vërtetohet se, pas kryerjes së ristrukturimit të fundit në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, pasi ka shqyrtuar propozimet e Komisionit të Ristrukturimit të DPD, ndërmjet të tjerave, me aktin nr. 625/2, datë 7.2.2019, ka miratuar transferimin e përhershëm të nëpunëses ***** në pozicionin, “*Specialist në Zyrën e Administratës*”, në Degën Doganore Fier dhe mbi këtë bazë, ka dalë akti nr. 7330, datë 23.3.2019, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, për emërimin e saj në pozicionin e mësipërm.

Pak kohë pasi ka marrë emërimin e mësipërm, rezulton se për nevoja të institucionit, me aktin nr. 13146, datë 28.5.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, punonjësja në fjalë, është transferuar përkohësisht në pozicionin “*Specialist, Sektori i Administratës dhe Shërbimit*”, Dega Doganore Tiranë. Pas plotësimit të afatit 6-mujor të transferimit, me aktin nr. 31307, datë 20.12.2019, është rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës si “*Specialist në Zyrën e Administratës*”, në Degën Doganore Fier.

Me pretendimin se rikthimi në pozicionin e mëparshëm të punës është bërë në kundërshtim me ligjin dhe për të rivendosur të drejtën e saj, nëpunësja në fjalë, këtë akt, e ka kundërshtuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila, me vendimin e ndërmjetëm datë 2.3.2020 ka vendosur marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar pezullimin e aktit nr.31307, datë 20.12.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, deri në përfundimin e gjykimit me vendim të formës së prerë, ndërsa, me vendimin nr. 277, datë 1.7.2020, kjo gjykatë, ka vendosur deklarinimin si absolutisht të pavlefshëm të aktit nr. 31307, datë 20.12.2019 për rikthimin e nëpunëses në pozicionin “*Specialist në Zyrën e Administratës*”, Dega Doganore Fier dhe detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të rikthejë nëpunësen ***** në pozicionin “*Specialist, Sektori i Administratës dhe Shërbimit*”, Dega Doganore Tiranë, vendim i cili është zbatuar nga institucioni me aktin nr.9813, datë 29.5.2020.

Më pas, rezulton se për nevoja të institucionit, me aktin nr. 17409, datë 1.10.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, punonjësja në fjalë, është transferuar përsëri, në mënyrë të përkohshme, në pozicionin “*Specialist, Sektori i Ankimimeve*”, Drejtoria Juridike, pranë DPD (ku vazhdon të punojë aktualisht). Me pretendimin se ky transferim është i paligjshëm, pasi është në fuqi masa e sigurisë dhënë nga gjykata administrative, në lidhje me

pezullimin e aktit nr. 31307, datë 20.12.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, si dhe në kushtet kur nuk është shprehur Gjykata e Apelit, punonjësja në fjalë, ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë dhe kthimin e saj në vendin e punës si “*Specialist, Sektori i Administratës dhe Shërbimit*”, Dega Doganore Tiranë, ku ajo është kthyer në bazë të vendimit të gjykatës.

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të transferimit të përkohshëm në këtë rast, që në fillim gjejmë me vend të evidentojmë që, për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, në legjislacionin specifik të tij (*pika 3 e nenit 13, të Kodit Doganor*), janë parashikuar disa rregulla të posaçme, të ndryshme nga ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, si në drejtim të llojeve të transferimeve, periodicitetit të tyre ashtu dhe të organit kompetent që urdhëron këto transferime.

Konkretisht, pika 7, e nenit 15, të këtij kodi, në shkronjën “a” parashikon: “*Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:*

- i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;*
- ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;*
- iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzanisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës.*

Pra, në germën “i”, të nenit 15, pika 7/a, të ligjit 102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, është evituar kufizimi i dispozitës së ngjashme të pikës 1/a, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, sipas së cilës lejohet të bëhet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 muaj (*njëherësh ose e copëzuar*) për nevoja të punës, por kjo jo më shumë se një periudhë 6-mujore, gjatë dy viteve, gjë që do të thotë se një nëpunës doganor mund të transferohet përkohësisht, për nevoja të institucionit, sa herë çmohet një gjë e tillë, sikurse është transferuar kërkuesja.

Pretendimi i saj se, ky transferim është i paligjshëm, pasi është në fuqi masa e sigurisë në lidhje me pezullimin e aktit nr. 31307, datë 20.12.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, është i pabazuar. Konkretisht, nëpërmjet këtij akti, nëpunësja është rikthyer në pozicionin “*Specialist në Zyrën e Administratës*”, Dega Doganore Fier, atje ku ajo kishte emërimin pas ristrukturimit të institucionit, për shkak të mbarimit të afatit 6-mujor të transferimit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, e ka konsideruar si akt në kundërshtim me ligjin, me arsyetimin se, nuk është zbatuar procedura në lidhje me të drejtën

e shprehjes së vullnetit të nëpunëses *****, nëse ajo pranon të vijojë të qëndrojë në pozicionin ku ishte transferuar, përpara kthimit në vendin e mëparshëm të punës, në zbatim të pikës 7, shkronja “c”, e nenit 15, të ligjit nr.102/2014, “Kodi Doganor i RSH”, i cili parashikon se: **“Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi kthehet në pozicionin e mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur nëpunësi pranon të vijojë në pozicionin ku ishte transferuar”**.

Pavarësisht se dispozita e mësipërme zbatohet vetëm kur ka miratim e pëlqim të dyanshëm, në zbatim të vendimit të gjykatës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me aktin nr.9813, datë 29.5.2020, të titullarit të institucionit, e ka kaluar nëpunësen në fjalë, në pozicionin “*Specialist, Sektori i Administratës dhe Shërbimit*”, Dega Doganore Tiranë, duke përmbushur në këtë mënyrë, detyrimin që përcakton pika 1, e nenit 66/1, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në vijimësi të punës dhe të nevojave të institucionit, kërkuesja, me aktin nr. 17409, datë 1.10.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, është transferuar përsëri përkohësisht, në pozicionin “*Specialist, Sektori i Ankimimeve*”, Drejtoria Juridike, pranë DPD, akt i cili, duke patur parasysh ç’ka u tha më sipër, në lidhje me rregullat e posaçme që parashikon Kodi Doganor për transferimin e përkohshëm, është i ligjshëm. Pra, nga ana e institucionit, është përmbushur detyrimi që përcakton vendimi i gjykatës për dhënien e masës provizore, duke e kthyer nëpunësen në pozicionin e mëparshëm të punës, ndërkohë që transferimi i mapsëm i saj në pozicionin si më sipër, është një veprim tjetër administrativ, në vazhdimësi të marrëdhënies së punës, i bërë brenda rregullave të parashikuara në legjislacionin doganor dhe atë të shërbimit civil e që nuk ndalohet prej tyre.

Më tej, duke u thelluar në përmbajtjen e aktit nr. 17409, datë 1.10.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, konstatohet një aspekt tjetër i paligjshmërisë së tij, pasi në këtë akt, nuk është shënuar kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm dhe nuk është shënuar dita e përfundimit të tij, por vetëm data e fillimit të efekteve të aktit.

Kjo, sipas arsytimit të njësisë së burimeve njerëzore, ka ndodhur pasi pika 7, shkronja “a” (i), e nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i RSH” parashikon në mënyrë të shprehur afatin maksimal të transferimit të përkohshëm, prandaj prezumohet që transferimi nuk mund të zgjasë më shumë se 6 muaj. Kjo mangësi evidentohet si një element paligjshmërie, pasi një akt i rregullt administrativ do të duhej të përcaktonte në mënyrë të shprehur, kohën e transferimit të përkohshëm dhe datën e kthimit të nëpunësit të transferuar në pozicionin e mëparshëm, gjë e cila do të siguronte një stabilitet në marrëdhënien e

punësimin në shërbimin civil dhe transparencën e nevojshme të procesit, duke i siguruar nëpunësit mundësinë që të kërkojë konkretisht rivendosjen e të drejtës së tij.

Në vijim të analizës, kuptimi dhe zbatimi i kufizimeve të parashikuara në pikën 1, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, duhet të vihen në zbatim nga ana e drejtuesit të institucionit dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në çdo rast që kryejnë transferime të përkohëshme. Dispozitat e ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, janë dispozita të një ligji kuadër, me karakter normativ, që shërbejnë për gjithë sistemin e shërbimit civil dhe menaxhimi korrekt i burimeve njerëzore, prezumon zbatimin e harmonizuar të dispozitave të posaçme të Kodit Doganor, me parimet dhe rregullat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil.

Kjo do të thotë që, pavarësisht se në ligjin nr. 102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, është evituar kufizimi që transferimi i përkohshëm i një nëpunësi civil nuk mund të lejohet për një kohë më shumë se 6 muaj gjatë dy vjetëve, kjo duhet të mbahet parasysh në mënyrë parimore nga menaxherët e burimeve njerëzore, në kuptimin që nëpunësi doganor të mund të transferohet për një afat tjetër, në vazhdim apo me përsëritje, vetëm në kushtet e ekzistencës së nevojës së domosdoshme të argumentuar, duke përcaktuar saktë në akt afatet e transferimit dhe duke mbajtur parasysh parimet e proporcionalitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, parashikuar përkatësisht në nenet 12 e 17, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, si dhe kufizimet e vendosura në shkronjën “c”, pika 7, të nenit 15, të Kodit Doganor dhe për të evituar përshtypjen që mund të krijohet se nëpunësi vihet para një situatë ndëshkimore disiplinore, të kamufluar me institutin e transferimit të përkohshëm.

Në vijim të arsyetimit të mësipërm, pas konstatimit të përfundimit të afatit maksimal 6-mujor të transferimit të fundit, kryer me aktin nr. 17409, datë 1.10.2021, në pozicionin *“Specialist, Sektori i Ankimimeve”*, Drejtoria Juridike, pranë DPD, nëpunësja *****, duhet të kthehet në pozicionin e saj të rregullt të punës, *“Specialist, Sektori i Administratës dhe Shërbimit”*, Dega Doganore Tiranë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, *“Mbi*

procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 993 prot., datë 18.10.2021, të nëpunëses ***** , në lidhje me pretendimet për parregullsi ligjore në kryerjen e transferimit të përkohshëm dhe arkivimin e çështjes, duke i vënë në dukje njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, të veprojë ne respektim të kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil, siç është trajtuar në pjesën arsyetuese e këtij vendimi.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha